



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -030

PËR PËRGJIMIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PËRGJIMIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj rregullon procedurat dhe kushtet mbi përgjimin e komunikimeve elektronike që realizohen për nevoja të procedurës penale nga institucionet shtetërore të themeluara me ligj, dhe procedurat dhe kushtet e përgjimit për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj të themeluara me ligj.
2. Ky ligj përcakton rregullat, detyrimet dhe procedurat për Operatorët e Rrjeteve dhe Ofruesit e Shërbimeve në lidhje me përpunimin e të dhënave të caktuara nga ana e tyre.
3. Ky ligj përcakton detyrimet dhe autorizimet e institucioneve shtetërore të themeluara me ligj për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në procesin e përgjimit të ligjshëm, si dhe kontrollin në zbatimin e procedurave të përgjimit.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky ligj zbatohet nga të gjitha institucionet e autorizuar, autoritetet kompetente për të urdhëruar përgjimin, Operatorët e Rrjetit dhe nga të gjithë Ofruesit e Shërbimeve Publike të licencuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe Institucionet dhe Autoritetet tjera të definuara dhe përcaktuara me këtë ligj.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Thirrje**-secila lidhje fikse apo e përkohshme që ka mundësinë e transferimit të informatave ndërmjet dy apo më shumë përdoruesve të sistemit të komunikimit elektronik;

1.2. **Përgjimi**-aktiviteti ligjor i sigurimit të qasjes dhe ofrimit të komunikimit elektronik të përgjimit të një caku dhe të dhënave që lidhen me thirrjen tek një Institucion i Autorizuar sipas Kapitullit 1 ose Kapitullit 2;

1.3. **Përgjim i komunikimeve elektronike**-përgjimi i komunikimeve zanore, komunikimeve tekstuale ose komunikimeve tjera përmes rrjeteve të telefonive fikse apo mobile. Kjo përfshinë çfarëdo mjeti apo sistemi tjetër të ngjashëm teknologjik që bartë të dhëna që kryesisht kanë për qëllim të jenë private;

1.4. **Qasja**-mundësia teknike për t'u ndërlidhur me një qendër të komunikimeve në atë mënyrë që një institucion i autorizuar, pas Urdhërit për përgjim, mund të merr dhe të monitorojë komunikimet dhe të dhënat që lidhen me thirrjet që janë bërë në atë qendër;

1.5. **Subjekt i Përgjimit**-një ose më shumë persona të identifikuar me autorizim ligjor të lëshuar nga gjykata kompetente në bazë të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe/ose Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë dhe komunikimet hyrëse dhe dalëse të të cilëve duhet të përgjohen dhe të monitorohen;

1.6. **Objekt përgjimi** janë sinjalet, shkrimet, fotografitë, të dhënat audiovizuale ose lloj tjetër informacioni, për tu marrë ose transmetuar nëpërmjet pajisjeve të komunikimit elektronik;

1.7. **Njësitë ndërlidhëse** -vendndodhja fizike e pajisjeve teknike nën administrimin dhe kontrollin e Kryeprokurorit të Shtetit, të përcaktuara në Nenin 15 të këtij ligji;

1.8. **Qendrat Monitoruese** -infrastrukturat e ndara të Policisë së Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë të përcaktuara në Nenin 17 të këtij ligji;

1.9. **Zyrtar i Autorizuar**-zyrtari i cili është i autorizuar, sipas urdhërit gjyqësorë të zbatojë të gjitha masat dhe mjetet mbi përgjimin të përcaktuara me urdhërin mbi përgjimin;

1.10. **Minimizim sipas urdhrit gjyqësor**- procesi teknik sipas të cilit zyrtari i autorizuar sipas urdhrit gjyqësor filtron të dhënat e marra gjatë përgjimit që nuk janë objekt i hetimit.

1.11. **Operator i Rrjetit**- operatori i infrastrukturës publike të komunikimit elektronik të licencuar ligjërisht që lejon bartjen e sinjaleve në mes të pikave të definuara të fundit të rrjetit me tel, mikrovalë, mjete optike apo me mjete elektromagnetike;

1.12. **Shërbimi i caktuar**- një shërbim të shoqëruar me një cak të përgjimit dhe zakonisht të specifikuar në autorizimin ligjor për përgjim;

1.13. **Komunikimi Elektronik**- secili transferim i shenjave, sinjaleve, të shkruarit, imazheve, tingujve apo të dhënave të ndonjë natyre të transmetuar në tërësi apo në veçanti përmes sistemit të telit, radios, elektromagnetik, foto-elektronik apo foto-optik;

1.14. **Komunikimi**- shkëmbimi ose bartja e çfarëdo informacioni ndërmjet një numri të caktuar pjesëmarrësish përmes një shërbimi të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut. Kjo nuk përfshin asnjë informacion që bartet si pjesë e shërbimeve transmetuese radio-televizive nëpërmjet një rrjeti të komunikimeve elektronike, përveç në rastin kur informacioni mund të jetë i lidhur me një parapagues ose shfrytëzues të identifikueshëm, i cili merr këtë informacion;

1.15. **Postë elektronike**- çdo mesazh në formë të tekstit, zërit, tingullit apo imazhit, i dërguar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve, i cili mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen fundore të marrësit derisa atë ta marrë ai;

1.16. **Ofrues i Shërbimeve**- ndërmarrësi i licencuar ligjërisht i cili ofron një apo më shumë shërbime të komunikimit elektronik publike pajisja e të cilit përmban në tërësi apo pjesërisht transmetimin dhe rrugëtimin e sinjaleve në rrjetin e komunikimit elektronik;

1.17. **Të dhënat që lidhen me thirrjen**- të dhënat e sinjalizimit të informatave që kalon ndërmjet një shërbimi objektiv dhe rrjeti ose një përdorues tjetër. Përfshin informacion sinjalizues që përdoret për themelimin e thirrjes dhe të kontrollojë progresin e saj (p.sh. thirrja në pritje, thirrje e bartur). Të dhënat që lidhen me thirrjen përfshijnë gjithashtu informacion në lidhje me thirrjen që është në dispozicion për operatorin / ofrues të shërbimit të rrjetit (p.sh. kohëzgjatja e lidhjes);

1.18. **ARKEP**-Autoriteti Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

1.19. **Të dhënat**- trafiku i të dhënave, të dhënat për vendndodhjen dhe të dhënat tjera të domosdoshme për të identifikuar parapaguesin ose shfrytëzuesin;

1.20. **Shfrytëzues**- çdo person fizik që përdor shërbimet publike elektronike në dispozicion, për qëllime private apo të biznesit, jo domosdoshmërisht i regjistruar për këtë shërbim;

1.21. **Shërbim telefonik**- thirrje (duke përfshirë zë, porosi me zë dhe video konferencë), shërbimet plotësuese (duke përfshirë transmetimin e thirrjeve dhe transferimin e thirrjes) dhe mesazhet apo shërbimet multimediale (duke përfshirë shërbimet e mesazheve të shkurtër, shërbime shtesë multimediale);

1.22. **Urdhëri i ligjshëm** -Urdhërin e ligjshëm për përgjim të lëshuar sipas Kapitullit 1 ose Kapitullit 2 të këtij ligji;

1.23. **ASHMDHP**- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

1.24. **KPPK**- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës;

1.25. **AKI** -Agjencia e Kosovës për Inteligjencë;

1.26. **KMPP**- Komisioneri për Mbikëqyrje të Procedurës së Përgjimeve të komunikimeve elektronike;

1.27. **Shërbimet për Mesazhe te Shkurta ("SMS")** -mesazh me tekst të komunikimit ndërmjet pajisjeve elektronike të komunikimit duke përfshirë, por jo kufizuar në, ato të telefonave celular, pagers dhe pajisje të tjera të komunikimit mobil;

1.28. **Për qëllim të këtij ligji Meta-Data** do të thotë të gjitha të dhënat në lidhje me komunikimet që i nënshtrohen urdhrin për përgjimin te ligjshëm, duke përfshirë, mes tjerash, kohën, kohëzgjatjen, burim, destinacion, vendndodhjen dhe llojin e pajisjeve të transmetimit apo pranimit të përfshirë në komunikime, por që përjashton përmbajtjen e një komunikimi.

Neni 4

Parimet themelore me rastin e përgjimit

1. Parimet themelore dhe udhëheqëse me rastin e përgjimit në përputhje me këtë ligj janë:

1.1. respekti për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të njohura dhe të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, përfshirë dhe ashtu siç janë interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përmes praktikës së saj gjyqësore;

1.2. ndalimi i përgjimit pa një vendim përkatës gjyqësor. Përgjim i ligjshëm konsiderohet vetëm ai për të cilin është lëshuar urdhër i ligjshëm nga gjykata kompetente për të autorizuar përgjimin.

2. Me rastin e marrjes së vendimit për përgjim, gjykata kompetente bartë detyrimin për t'u kujdesur për:

2.1. esencën e të drejtave dhe lirive të personave për të cilët është bërë kërkesë përgjimi;

2.2. rëndësinë, nevojën e përgjimit, dhe proporcionalitetin;

2.3. natyrën, mjetet dhe vëllimin e përgjimit;

2.4. raportin në mes të qëllimit që synohet të arrihet dhe mundësisë së realizimit të këtij qëllimi me metoda tjera hetuese; dhe

2.5. sekretin dhe objektivitetin gjatë kryerjes së përgjimit.

3. Me rastin e vendosjes për një kërkesë përgjimi dhe përpara se të autorizohet përgjimi si masë hetuese ose e mbledhjes së informacionit, gjykata kompetente duhet të sigurohet që janë shtjerrë të gjitha masat tjera të hetimit ose të mbledhjes së informacionit.

4. Bazuar në Kushtetutën e Kosovës ku liria e shprehjes dhe e mediave garantohet dhe është standard i të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike, gjykata kompetente është e obliguar të mbrojë të drejtat e gazetarëve për ruajtjen e burimeve të informacionit dhe për mos zbulimin e burimit të mbrojtur të informatës të përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë dhe Kodin Penal të Kosovës gjatë ushtrimit të funksionit të tyre si pjesë e lirisë së shprehjes dhe informimit të publikut përcjellë me garancionet e Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe praktikën e gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi mbrojtjen e burimeve të gazetarëve.

Neni 5 **Llojet e përgjimit**

1. Për qëllime të këtij ligji, institucionet e autorizuar do të zbatojnë përgjimet për nevojat në vijim:

1.1. përgjimi për nevoja të procedurës penale; dhe

1.2. përgjimi për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Neni 6 **Procedura e vendosjes për përgjimin**

1. Procedura për përgjim të ligjshëm zhvillohet në tri faza të veçanta:

1.1. parashtrimi i kërkesës për përgjim nga institucioni i autorizuar me ligj;

1.2. shqyrtimi, miratimi dhe paraqitja e kërkesës për përgjim; dhe

1.3. urdhëri gjyqësor për përgjim.

2. Një përgjim i ligjshëm për qëllime të këtij ligji mund të realizohet vetëm pasi të ketë kaluar nëpër të tri fazat e procedurës nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 7 **Kufizimet në përgjim**

Autoritet kompetente për të urdhëruar përgjimin dhe institucionet e autorizuar janë të obliguara të mbrojnë të drejtat e gazetarëve për të ruajtur burimin e informacionit dhe të ndalojnë zbulimin e burimit të mbrojtur të informatës nga personat të cilët marrin pjesë si profesionist (gazetarët) në publikimin e informacionit ose si anëtar i bordit redaktues të mediave dhe ndihmësi i tij të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, Kodin Penal të Kosovës dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

KREU II
PROCEDURAT DHE KUSHTET E PËRGJIMIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE PËR QËLLIME TË PROCEDURES PENALE

Neni 8

Institucionet e autorizuar për të parashtruar kërkesë për përgjim të ligjshëm

1. Për qëllime të Procedurës Penale, Prokurori i Shtetit është institucioni i vetëm i autorizuar për të parashtruar kërkesë për përgjim të ligjshëm të komunikimeve elektronike pranë gjykatës kompetente.
2. Institucionet e autorizuar për të propozuar kërkesë pranë Prokurorit të Shtetit për përgjim të ligjshëm për qëllime të procedurës penale janë: Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Inspektorati Policor i Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, si dhe Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë - EULEX, sipas kompetencave të dhëna me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Institucionet e autorizuar në bazë të paragrafit 2 të këtij neni do të ushtrojnë autorizimet nga ky nen vetëm me qëllim të sigurimit të të dhënave të domosdoshme për realizimin e detyrave të tyre ligjore.
4. Asnjë prej institucioneve të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni nuk ka të drejtë dhe autorizim të parashtojë një kërkesë për përgjim për çështje ose veprimtari që nuk janë parashikuar me ligj dhe të cilat nuk janë në fushën e përgjegjësive dhe të veprimtarisë së tyre zyrtare.

Neni 9

Kërkesa për përgjim

1. Kërkesa për përgjim duhet të hartohet në kopje të mjaftueshme, një kopje e së cilës depozitohet pranë Prokurorit të Shtetit dhe një e mbanë vetë institucioni i cili kërkon lëshimin e Urdhërit për përgjim.
2. Përveç kushteve të përcaktuara në Nenet 84-100 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, një kërkesë e institucionit të autorizuar për përgjim të ligjshëm duhet të jetë në përputhje me Nenin 4 të këtij ligji si dhe të përmbajë edhe informatat në vijim:
 - 2.1. të dhënat e personit zyrtar dhe mbikëqyrësit, si dhe funksionet e atyre të cilët kërkojnë masën e përgjimit;
 - 2.2. të dhënat personale dhe adresën e subjektit që i nënshtrohet masës së përgjimit nëse janë të njohura;
 - 2.3. emërtimi ligjor i masës dhe baza ligjore e saktë e saj;

2.4. përshkrimin e telekomunikimeve që do të përgjohen për qëllime të procedurës penale dhe të dhënat për operatorin e telekomunikacionit që i ofron shërbim subjektivit që do të përgjohet;

2.5. arsyetimi i detajuar përmes të cilit dëshmohet që përgjimi është i domosdoshëm, si dhe arsyetimin që të dhënat të cilat kërkohet nuk mund të sigurohen me mjete tjera të hetimit apo sigurimit të informacionit;

2.6. afatin kohor brenda të cilit kërkohet të bëhet përgjimi.

Neni 10

Autoriteti kompetent për të urdhëruar masën e përgjimit në procedurën penale

1. Masa e përgjimit të komunikimeve elektronike, përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet e tjera elektronike, përgjimit të komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik duhet të urdhërohet vetëm nga gjykata me kërkesë të Prokurorit të Shtetit, përveç rasteve kur në procedurën penale urgjente vepron sipas Urdhërit të përkohshëm të dhënë në formë të shkruar në pajtim me parimet e këtij ligji.

2. Në procedura penale urgjente, autoriteti kompetent për të urdhëruar me shkrim masën e përgjimit të përkohshëm është edhe Prokurori i Shtetit në kuptim të nenit 91 të KPPK-së.

3. Urdhëri i përkohshëm nga paragrafi 2 i këtij neni pushon të ketë efekt dhe çfarëdo informate apo provë e marr gjatë kësaj periudhe nuk do të jetë e ligjshme nëse Urdhëri i tillë nuk konfirmohet me shkrim nga Gjyqtari kompetent brenda tri (3) ditëve nga lëshimi i tij si dhe Urdhëri nga paragrafi 2 i këtij neni nuk mund të përsëritet.

4. Prokurori i Shtetit është i obliguar sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) që para dhënies së Urdhërit të përkohshëm të garantoj respektimin e parimeve nga neni 4 i këtij ligji.

Neni 11

Urdhëri për përgjimit

1. Urdhëri për përgjimit i nxjerrë në procedurën penale duhet të jetë në përputhje me nenin 4 të këtij ligji.

2. Urdhëri për masën e përgjimit nuk duhet të lëshohet për një periudhë më të gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e lëshimit të Urdhërit dhe mund të vazhdohet vetëm sipas kritereve të përcaktuara me këtë ligj dhe KPPK.

3. Përveç kushteve të kërkuara sipas KPPK, Urdhëri për përgjimit duhet të përmbajë edhe informatat në vijim:

3.1. obligimet për zyrën Prokurorit të Shtetit, Operatorët e Rrjetit dhe/ose Ofruesit të Shërbimeve, si dhe Sektorit për Përgjimit;

3.2. Institucionin që ka bërë kërkesën;

- 3.3. të dhënat personale dhe adresën e subjektit që i nënshtrohet masës së përgjimit nëse janë të njohura;
 - 3.4. numrin e protokollit;
 - 3.5. afatin ose afatet e përgjimit, ku përcaktohet data dhe ora e fillimit dhe e mbarimit;
 - 3.6. operatorin e telekomunikacionit që siguron komunikimin;
 - 3.7. pajisjet fundore që përdor subjekti i përgjimit për realizimin e komunikimeve elektronike; dhe
 - 3.8. arsyetimi që vërtetojnë se përgjimi është i domosdoshëm dhe së të dhënat që kërkohen nuk mund të sigurohen me mjete të tjera të hetimit apo mbledhje së informacionit.
4. Gjatë zbatimit të urdhrin për përgjim zyrtari i autorizuar me urdhër gjyqësor është i obliguar për minimizimin e përgjimit sipas urdhrin gjyqësor.

Neni 12

Obligimet e zyrtarit të autorizuar

1. Zyrtari i autorizuar për përgjim në bazë të këtij ligji është i detyruar të zbatojë të gjitha masat dhe mjetet të përcaktuara me Urdhërin mbi përgjimin në atë mënyrë e cila siguron origjinalitetin, tërësinë dhe sigurinë e të dhënave të mbledhura përmes përgjimit.
2. Zyrtari i autorizuar ka për obligim që të sigurojë se asnjë përgjim i ligjshëm nuk bëhet pa Urdhërin për përgjim të lëshuar nga gjykata relevante në përputhje me nenin 11 të këtij ligji.

Neni 13

Spektori i Përgjimeve në kuadër të Policisë së Kosovës

1. Spektori i Përgjimeve në kuadër të Policisë së Kosovës përmes qendrës monitoruese realizon proceset teknike të përgjimit përmes pajisjeve të telekomunikimit për llogari të institucioneve shtetërore të zbatimit të ligjit dhe hetimit të veprave penale sipas vendimit paraprak të marrë në bazë të këtij Ligji dhe KPPK-së.
2. Spektori i Përgjimeve ligjore duhet të sigurohet se Urdhëri për përgjim përmban të gjitha të dhënat e kërkuara nga neni 9 i këtij ligji dhe të ekzekutojë vetëm kërkesat e lëshuara në përputhje të plotë me dispozitat e këtij Ligji dhe KPPK-së. Nëse kërkesa nuk i përmban të gjitha shënimet ajo kthehet mbrapa tek zyrtari i autorizuar.
3. Spektori për Përgjimeve ligjore evidenton kërkesën për përgjim si dhe kujdeset për plotësimin e formularit të pranimit/dorëzimit të Urdhërit për përgjim. Formulari i pranimit/dorëzimit të Urdhërit për përgjim duhet të përmbajë: llojin e Urdhërit ose kërkesës, detajet nga Urdhëri për përgjim, emrin e të dyshuarit, të dhënat për zyrtarin e autorizuar që kërkon përgjimin dhe mbikëqyrësin e tij për zbatim të Urdhërit, listën e personelit të autorizuar për

qasje në materialet e përgjuara, provat dhe materialet tjera relevante për përgjimin, dokumentin e identitetit të zyrtarit të autorizuar apo të deleguarit të tij i cili bënë kërkesën;

4. Secila kërkesë për përgjim nënshkruhet nga zyrtari pranues dhe shefi i Sektorit të Përgjimit.

5. Sektori për përgjim duhet të jetë në dispozicion përmes kujdestarisë njëzetekatër (24) orë shtatë (7) ditë të javës, kryesisht në raste emergjente siç parashihet me Kodin e Procedurës Penale.

6. Subjekti i përgjimit pas përfundimit të masës së ndërmarrë njoftohet me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

KREU III

PROCEDURAT DHE KUSHTET E PËRGJIMIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PËR NEVOJAT E SIGURISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QYTETARËVE TË SAJ

Neni 14

Procedurat dhe Kushtet e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike për Nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Qytetarëve të saj

Përgjimet për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj realizohen në përputhje me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, pas lëshimit të Urdhërit gjyqësor të gjyqtarit të Gjykatës Supreme, në përputhje me nenin 4 mbi parimet themelore të përgjimit të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 15

Sistemi i përgjimit

1. Sistemi i përgjimit është i përbërë nga dy pjesë të cilat nuk mund të funksionojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra:

1.1. Njësisë ndërlidhëse dhe

1.2. Qendrës monitoruese.

2. Prodhimi, vënia në treg, shitja ose mbajtja e mjeteve për përgjimin e komunikimeve elektronike, në kuptim të nenit 15, paragrafi 1 të këtij ligji lejohet vetëm kur është në përputhje me ligjet e aplikueshme të Kosovës dhe zhvillohet sipas procedurave përkatëse nga organet kompetente, pa siguruar një vendim të Qeverisë.

3. Hapësirat ku vendosen njësia ndërlidhëse dhe qendrat monitoruese duhet të garantojnë sigurinë e plotë të informacionit të marrë nëpërmjet përgjimit, duke përfshirë sistemin e monitorimit dhe menaxhimit të tyre.

4. Çdo hyrje dhe dalje në hapësirat e tilla duhet regjistruar dhe mbajtur nën vëzhgim nga një sistem i vëzhgimit njëzetekatër (24) orësh, përfshirë gjurmën për identitetin e zyrtarit, datën dhe orën e hyrjes në të, informacionet dhe veprimet tjera të marra në atë periudhë kohore, si dhe kohën e qëndrimit në të, që garanton qasje të mëvonshme në të në lidhje me hetimet ndaj mospërputhjeve të të dhënave apo për verifikime tjera.

5. Hapësirat e tilla duhet të garantojnë qasje të kufizuar në rastet kur zbatohet një urdhër për përgjim.

Neni 16 **Njësia ndërlidhëse**

1. Njësia ndërlidhëse është pajisje teknike e cila aktivizon ose ndalon përgjimin e një pajisjeje fundore pas Urdhrit të ligjshëm për përgjim të lëshuar nga Gjykata kompetente, nën administrimin dhe kontrollin e Kryeprokurorit të Shtetit.

2. Njësia ndërlidhëse duhet të posedojë një softuer dhe sistem teknik që garanton ruajtjen e gjurmëve të plota mbi përdorimin e saj në pajtim me këtë ligj.

3. Njësia Ndërlidhëse duhet të mirëmbajë regjistrat e aktivizimeve të përgjimeve. Regjistrat e tillë ruhen në pajtim me legjislacionin sekondar të nxjerr nga Këshilli Prokurorial, pas konsultimit dhe marrëveshjes me Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, dhe raportohet sipas kërkesës për vëmendje të Komisionerit në zbatim të funksioneve të përcaktuar në Kreun V të këtij ligji.

4. Autoriteti që administron Njësinë Ndërlidhëse i përgjigjet vetëm gjykatës dhe vepron vetëm në bazë të Urdhërit gjyqësor të ligjshëm. Pas pranimit të këtij Urdhëri, autoriteti i tillë mundëson dhe lehtëson në aspektin teknik procesin e përgjimit në Qendrat Monitoruese të vendosura në Policinë e Kosovës dhe Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

5. Njësia ndërlidhëse nuk mund të transmetojë komunikime të përgjuara tek institucione apo palë të treta përveç ashtu siç është përcaktuar në Urdhërin që autorizon përgjimin dhe në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

6. Njësia ndërlidhëse duhet t'u bindet urdhëresave ligjore dhe të zbatojë masat e përgjimit të kërkuar sa më parë që të jetë e mundur dhe pa ndonjë vonesë të pajustificuar.

Neni 17 **Përgjimet Paralele**

1. Njësia ndërlidhëse duhet të kenë kapacitetin e nevojshëm teknik dhe organizativ për të zbatuar përgjime paralele të shumëfishta për një cak të vetëm në Qendrat Monitoruese kur kjo kërkohet nga institucionet e autorizuar pas Urdhërit të ligjshëm të Gjykatës me juridiksion kompetent. Në raste të tilla, zyrtarët e Njesisë Ndërlidhëse, Qendrës Monitoruese, Operatorëve të Rrjetit dhe Ofruesve të Shërbimeve marrin masat e domosdoshme që të ruajnë identitetin e institucioneve të autorizuar përkatese dhe do të ruajnë fshehtësinë e përgjimeve sipas këtij ligjit.

2. Standardet teknike lidhur me përgjimet paralele dhe për numrin maksimal të përgjimeve paralele për një numër të caktuar të abonentëve përcaktohen në legjislacionin sekondar, të lëshuar nga ARKEP në pajtim me Kryeprokurorin e Shtetit, por të cilat duhet të jenë në përputhje me parimet e përcaktuara me nenin 4 të këtij ligji dhe me praktikat më të mira evropiane.

Neni 18 **Qendra Monitoruese**

1. Qendra Monitoruese nënkupton infrastrukturën e ndarë të institucioneve të autorizuar në pikën 2 të këtij neni, të përcaktuar si destinacion i transmetimit për komunikimet e përgjuara dhe i të dhënave që lidhen me thirrjen e ndonjë caku të caktuar të përgjimit, dhe ku është e vendosur pajisja për monitorim dhe incizim.

2. Qendrat Monitoruese do të vendosen në Policinë e Kosovës për përgjimet e komunikimeve elektronike në kuadër të Kreun I për qëllime të procedurës penale dhe që përfshinë të gjitha institucionet e autorizuar me ligj dhe do të vendosen në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë për përgjimet e komunikimeve elektronike në kuadër të Kreun II për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj. Njësitë monitoruese duhet të posedojnë një softuer dhe sistem teknik që garanton ruajtjen e gjurmëve të plota mbi përdorimin e tyre.

3. Personave të ngarkuar me funksionin apo detyra të caktuara në ose për procesin e përgjimit në tërësi apo në veçanti u ndalohej:

3.1. të përhapin ose të përdorin të dhënat e grumbulluara jashtë kërkesave të këtij ligji apo të ligjeve në fuqi;

3.2. procesi teknik i përgjimit, në tërësi ose në veçanti, përbën informacion të klasifikuar, shkelja e të cilit dënohet sipas legjislacionit penal në fuqi.

Neni 19 **Obligimet e Operatorëve të Rrjetit**

1. Secili Operator i Rrjetit obligohet që me shpenzimet e veta të realizojë infrastrukturën e nevojshme në rrjetin e tyre, për të siguruar aftësinë përgjuese ndaj përdoruesve që shfrytëzojnë shërbimet e telekomunikimeve prej tyre.

2. Infrastruktura që realizohet nga operatorët e telekomunikacioneve përfshinë njësinë ndërlidhëse e cila siguron aftësinë përgjuese e cila duhet të jetë në përputhje me pajisjet e Qendrave Monitoruese.

3. Operatorët e rrjetit janë të detyruar të ofrojnë pa pagesë çdo shërbim në funksion të procesit të përgjimit.

4. Kur operatorët e rrjetit bëjnë përmirësimin e teknologjive, ata detyrohen të mbulojnë me shpenzimet e veta vazhdueshmërinë e funksionimit të procesit të përgjimit.

Neni 20

Parimi i fshehtësisë së përgjimit

1. Secili përgjim i ligjshëm i cili mundësohet nga Njësia Ndërlidhëse, Qendra Monitoruese, një Operator i Rrjetit dhe një Ofrues i Shërbimeve zhvillohet duke respektuar parimin e fshehtësisë dhe procedurat e parapara me këtë ligj, në atë mënyrë që as caku i përgjimit e as ndonjë person tjetër i paautorizuar nuk guxojnë të jenë në dijeni për përgjimin.
2. Asnjë informatë për caqet e përgjimit dhe për mënyrën si kryhen përgjimet nuk duhet të raportohet apo në ndonjë mënyrë të vihet në dispozicionin e publikut apo personave të paautorizuar, përveç nëse është e kërkuar me ligj.
3. Çdo e dhënë e mbledhur, e ruajtur apo e transmetuar në lidhje me një përgjim duhet të mbrohet në atë mënyrë që të parandalohet dhe të ndalohej përdorimi i paautorizuar ose i paligjshëm i një të dhëne të tillë, dhe do të trajtohet sipas standardeve të këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.

Neni 21

Siguria e Përgjimit

1. Çdo person i punësuar apo i kontraktuar nga Njësia Ndërlidhëse, Qendrat Monitoruese, dhe Operatori Rrjetit për instalimin, operimin ose mirëmbajtjen e objekteve, pajisjeve, interfejsëve dhe softuerëve të përgjimeve, duke përfshirë të gjithë të punësuarit të cilët trajtojnë ose mund të vihen në dijeni, duhet të ketë një verifikim sigurie të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimet e Sigurisë.
2. Objektet, pajisjet, interfejsët dhe softuerët që do të instalohen dhe përdoren për qëllime të përgjimit duhet të kenë një verifikim të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës, që vërteton se ato përputhen me kërkesat teknike dhe të sigurisë të përcaktuara në legjislacionin sekondar të lëshuar nga ARKEP.

Neni 22

Mbikëqyrja dhe Ndëshkimet

1. Pas paraqitjes me shkrim dhe të arsyetuar nga një institucion i autorizuar, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (Autoriteti) duhet të lejojë Operatorin e Rrjetit ose Ofruesin e Shërbimit që të merr çfarëdo masash të nevojshme, të cilat kërkohen për të siguruar pajtueshmërinë me këtë ligj dhe ligjet tjera të aplikueshme për përgjimet dhe me legjislacionin sekondar të nxjerrë në pajtim me këto ligje.
2. Në rast të mospajtimit nga Operatori i Rrjetit ose Ofruesi i Shërbimit me Urdhërin apo vendimin e lëshuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, si dhe shkeljes së dispozitave të përkufizuara me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij ligji, Autoriteti konform procedurave për sanksionet ekonomike të Ligjit për Komunikime Elektronike mund të ndëshkojë Operatorin e Rrjetit ose Ofruesin e Shërbimit respektiv me gjobë prej EUR 86,000 deri në 7% nga të hyrat vjetore nga aktivitetet që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike, duke e

marrë parasysh seriozitetin e mospajtimit dhe implikimet e tij për institucionet e zbatimit të ligjit dhe sigurinë kombëtare.

3. Në rast të mospajtimit të përsëritur me urdhrat apo vendimet e lëshuara në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Autoriteti mund të procedoj me nxjerrjen e Urdhërit për suspendimin të autorizimit të Operatorit të Rrjetit ose Ofruesit të Shërbimit respektiv, deri në kohën kur pajtimi me Urdhërin e Autoritetit është garantuar.

4. Në rast të mospajtimit të përsëritur me urdhra të lëshuara në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij Neni, që rezultojnë ose ka gjasa të rezultojnë në një kërcënim për sigurinë kombëtare apo që vështirësojnë rëndë operacionet e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe rendit, Autoriteti mund ta tërheq (revokoj) licencën/autorizimin e Operatorit të Rrjetit ose Ofruesit të Shërbimit respektiv.

5. Me qëllim të ushtrimit të përgjegjësive sipas këtij neni, Autoriteti autorizohet që të hyjë dhe të inspektojë objektet dhe operacionet e Operatorëve të Rrjetit ose Ofruesve të Shërbimit respektivë gjatë orëve të rregullta të punës dhe të kërkojë nga Operatori i Rrjetit ose Ofruesi i Shërbimit respektiv të gjitha informatat dhe dokumentacionin që vlerëson se janë të domosdoshme për ushtrimin e përgjegjësive sipas këtij neni.

Neni 23

Shkatërrimi i të dhënave të përgjimit

Pas arritjes së qëllimit dhe detyrave të institucioneve të autorizuara dhe autoriteteve tjera relevante në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj dhe fushëveprimin të tyre, të dhënat nga përgjimet duhet të shkatërrohen në përputhje me detyrimet e përcaktuara në KPPK dhe Ligjin për AKI-në.

KREU IV

RUAJTJA DHE SHKATËRRIMI I TË DHËNAVE

Neni 24

Llojet e të dhënave

Të dhënat të cilat referohen në kuadër të këtij kapitulli do të jenë të dhënat elektronike të përkufizuara me Ligjin për Komunikime Elektronike, të cilat kanë të bëjnë me shërbimin e mesazheve të shkurtra.

Neni 25

Ruajtja e të dhënave

1. Të gjitha të dhënat e marra përmes përgjimit të ligjshëm do të ruhen në mënyrë të sigurt, siç kërkohet nga Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

2. Qasja në të dhënat e marra përmes përgjimit të ligjshëm do të kufizohet në mënyrë strikte vetëm me ata individë të cilët janë drejtpërdrejt të përfshirë në hetimin e çështjes me të cilën ndërliken të dhënat si dhe me individët të cilët janë të nevojshëm për zbatimin teknik të Urdhërit për përgjimin e ligjshëm.

3. Vetëm të dhënat të cilat janë drejtpërdrejt të rëndësishme për hetimet zyrtare dhe hetimet në vazhdim e sipër mund të ruhen.

Neni 26

Ruajtja dhe shkatërrimi i të dhënave brenda qendrës monitoruese

1. Kryeprokurori i Shtetit ose i deleguari i tij do të sigurojë që çdo e dhënë e marr përmes përgjimit të ligjshëm do të ruhet vetëm brenda Qendrës Monitorimit, për sa kohë që ajo informatë është e rëndësishme për një hetim të hapur.

2. Çfarëdo të dhëna të marra përmes përgjimit të ligjshëm, dhe çdo kopje që mbahet në kuadër të Qendrës Monitorues do të fshihet në mënyrë të përhershme dhe/ose shkatërrohet nga Kryeprokurori i Shtetit apo të deleguarit e tij brenda tre muajve kalendarik pasi të mos i shërbejë më hetimeve.

3. Kryeprokurori i Shtetit ose i deleguari i tij do të fshij dhe/ose të shkatërrojë çdo të dhënë të mbetur nga përgjimi i ligjshëm që mbahet në kuadër të Qendrës së Monitorimit jo më vonë se dymbëdhjetë muaj pas përfundimit të hetimeve.

Neni 27

Ruajtja apo shkatërrimi i të dhënave brenda Objektivit të përgjimit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ("KPSH")

1. Kryeprokurori i Shtetit ose i deleguari i tij do të sigurohet që çdo e dhënë personale e marr përmes përgjimit të ligjshëm do të ruhet vetëm brenda objektivit të KPSH-së për përgjim, për sa kohë që ajo është e rëndësishme për një hetim të hapur.

2. Çdo e dhënë e cila merret përmes përgjimit të ligjshëm, dhe çdo kopje e saj, do të fshihet në mënyrë të përhershme dhe/ose shkatërrohet nga Kryeprokurori i Shtetit ose të deleguarit e tij brenda tre muajve kalendarik pasi të mos i shërbejë më hetimeve.

3. Kryeprokurori i Shtetit ose i deleguari i tij do të fshij dhe/ose të shkatërrojë çdo të dhënë të mbetur që ka rezultuar nga përgjimi i ligjshëm jo më vonë se dymbëdhjetë muaj pas përfundimit të hetimeve.

Neni 28

Ruajtja dhe shkatërrimi i të dhënave brenda të objektivit të përgjimit të Policisë së Kosovës

1. Drejtori i Policisë së Kosovës apo të deleguarit e tij do të sigurohen që çfarëdo e dhënë e marr përmes përgjimit të ligjshëm do të ruhet vetëm brenda objektivit të Policisë së Kosovës për përgjim për sa kohë që është relevante për një hetim të hapur.

2. Çdo e dhënë e cila merret përmes përgjimit të ligjshëm, dhe çdo kopje e saj, do të fshihet në mënyrë të përhershme dhe/ose shkatërrohet nga Drejtori i Policisë së Kosovës ose të deleguarit e tij, brenda tre muajve kalendarik pasi të mos i shërbejë më hetimeve.
3. Drejtori i Policisë së Kosovës ose i deleguari i tij do të fshij dhe/ose shkatërrojë çdo të dhënë të mbetur që ka rezultuar nga përgjimi i ligjshëm, jo më vonë se nëntë (9) muaj pas përfundimit të hetimeve.
4. Prokurori që përfaqëson Kryeprokurorin e Shtetit, do të monitorojnë personalisht shkatërrimin e të dhënave të lartpërmendura nga Policia e Kosovës.

Neni 29

Ruajtja dhe shkatërrimi i të dhënave brenda Agjencisë Kosovare të Inteligjencës

1. Drejtori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës apo të deleguarit e tij do të sigurohen që çfarëdo e dhënë e marr përmes përgjimit të ligjshëm do të ruhet vetëm për sa kohë që është e rëndësishme për një hetim që është duke u zhvilluar dhe që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e një Urdhëri të një gjykatësi të Gjykatës Supreme.
2. Çdo e dhënë e cila merret përmes përgjimit të ligjshëm, dhe çdo kopje e saj, do të fshihet në mënyrë të përhershme dhe/ose shkatërrohet nga Drejtori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës ose të deleguarit e tij, brenda një muaji kalendarik pasi të mos i shërbejë më hetimit që ndërlidhet me një operacion të ligjshëm të përgjimit të autorizuar nga një gjykatës i Gjykatës Supreme.
3. Përveç kur heqja dorë nga përgjegjësia mund të merret me shkrim nga një gjyqtar i Gjykatës Supreme, drejtori i agjencisë së Inteligjencës së Kosovës ose i deleguari i tij do të fshij dhe/ose të shkatërrojë çfarëdo të dhënë të mbetur që ka rezultuar nga një përgjim i ligjshëm, jo më vonë se dymbëdhjetë muaj nga përgjimi i parë.
4. Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë do të monitorojë personalisht shkatërrimin e të dhënave të lartpërmendura nga ana e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Neni 30

Ruajtja dhe shkatërrimi i të dhënave nga operatorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimeve

1. Operatorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimeve nuk do të regjistrojnë, ruajnë apo kopjojnë të dhënat e çfarëdo thirrjeje apo mesazhi.
2. Operatorëve të rrjetit dhe ofruesve të shërbimeve ju lejohet të ruajt meta-datat për një periudhë maksimale prej nëntë (9) muajve kalendarik dhe të dhënat e tilla do të i vë në dispozicion të institucionit të autorizuar, në përputhje me ligjet aktuale, për një periudhë që nuk kalon nëntë (9) muaj kalendarik.
3. Pas skadimit të periudhës prej nëntë (9) muajve kalendarik, operatorët e rrjetit do t'i fshijnë dhe/ose të shkatërrojnë të dhënat si dhe çfarëdo kopje të tyre.

4. Operatorët e rrjetit duhet t'i sigurojnë informata Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Komisionerit për kontrollimin e ligjshmërisë së përgjimit në lidhje me sasinë dhe llojin e të dhënave të përgjimit që ata kanë shkatërruar në baza gjashtë-mujore.

Neni 31 Periudha tranzicionale

1. Operatorët e të dhënave dhe ofruesit e shërbimeve do të sigurojnë, prokurojnë, instalojnë, mirëmbajnë dhe përdorin objektet teknike, pajisjet, ndërfaqet dhe softuerët me qëllim të zbatimit të përgjimit të ligjshëm, si dhe do të bëjë aranzhimet e nevojshme organizative me qëllim që të mundësoj përgjimin e ligjshëm siç kërkohet nga ky ligj, brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të ligjit aktual.

2. Të dhënat e ndërlidhura me thirrjet telefonike, duke përfshirë përmbajtjet e çfarëdo komunikimi të mbledhur dhe ruajtur nga Operatorët e Rrjetit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të ruhen nga operatorët e rrjetit dhe do të vihen në dispozicion të institucioneve të autorizuar në përputhje me ligjin aktual, për një periudhë që nuk tejkalon nëntë (9) muaj. Pas skadimit të periudhës prej nëntë (9) muajsh, të dhënat do të shkatërrohen në përputhje me nenin 13 të këtij ligji.

3. Një përfaqësues i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Komisioneri për kontrollin e ligjshmërisë së përgjimit do të monitorojë personalisht shkatërrimin e të dhënave.

KREU V KOMISIONERI PËR MBIKQYRJEN E PROCESIT TE PËRGJIMEVE

Neni 32 Mbikëqyrja e përgjimeve

1. Përmes këtij ligji themelohet mekanizmi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Procesit të Përgjimeve të Komunikimeve (Komisioneri).

2. Komisioneri është një mekanizëm i vendosur në kuadër të strukturës institucionale të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili bën kontrollin vjetor të ligjshmërisë së përgjimeve të komunikimeve sipas këtij ligji dhe i raporton Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit në baza vjetore mbi shkeljet eventuale të identifikuar.

3. Komisioneri është i pavarur në kryerjen e funksioneve dhe detyrave të parapara me këtë ligj, dhe ka një buxhet të veçantë brenda buxhetit vjetor operues të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shpenzimin e të cilit i raporton Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Neni 33

Emërimi i Komisionerit

Komisionerin e emëron Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nga përbërja e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës. Komisioneri emërohet për një mandat katër (4) vjeçar dhe i raporton Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe i nënshtrohet parimeve të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 34

Funksionet e Komisionerit

1. Komisioneri ushtron kontroll të rregullt vjetor mbi ligjshmërinë e tërë procesit të përgjimeve nga institucionet e autorizuara me këtë ligj.

2. Kontrolli vjetor përfshin një raportim të detajuar e që është publik, duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave dhe qëllimeve të përgjimit, dhe që analizon:

2.1. monitorimin e koordinimit institucional gjatë zbatimit të përgjimit të komunikimeve elektronike bazuar në kërkesat e këtij ligji, duke përfshirë edhe shkeljet eventuale, dhe hartimin e rekomandimeve adekuate;

2.2. krahasimin në mes të gjurmëve të përgjimit në pajisjet brenda 'njësisë ndërlidhëse' dhe 'qendrës monitoruese' dhe vendimeve për përgjim të ligjshëm të lëshuara në atë periudhë kohore;

2.3. monitorimin, sipas mostrave të caktuara, të standardeve ligjore të vendimeve gjyqësore për përgjim të ligjshëm të lëshuara në atë periudhë kohore dhe promovimin e unifikimit të tyre brenda sistemit gjyqësor të Kosovës;

2.4. identifikimin e shkeljeve të këtij ligji në zbatimin e procedurave të ushtrimit të përgjimit të ligjshëm;

2.5. verifikimin nëse personat e autorizuar në kuadër të institucioneve të autorizuara për përgjim të ligjshëm e kanë ushtruar një mandat të tillë; dhe

2.6. verifikimin e shkatërrimit të informacioneve të mbledhura nga procesi i përgjimit, sipas kërkesave të këtij ligji, KPPK-së, dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Konkluzionet dhe shkeljet e mundshme të gjetura nga Komisioneri nuk kanë efekt juridik në procedurën penale dhe vendimet e gjykatave kompetente. Konkluzionet e nxjerra nga Komisioneri shqyrtohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në rastet kur ato lidhen me përgjimin në procedure penale apo Inspektori i Përgjithshëm i AKI-së në rastet që lidhen me përgjimin e ligjshëm për nevojat e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

4. Në rastet kur konstatohen shkelje, Këshilli Gjyqësor i Kosovës i adreson ato në Panelin për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit sipas KPPK-së, kurse Inspektori i Përgjithshëm i adreson sipas kompetencave në bazë të Ligjit për AKI-në.

5. Komisioneri do të njoftoj Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me gjetjet e raportit. Agjencia përkatëse në përputhje me kompetencat e saj ligjore, do të ndërmerr veprimet që i konsideron të nevojshme për të adresuar konkluzionet dhe gjetjet nga raporti i Komisionerit.

6. Në rast të konstatimit të mos-përputhjes dhe lëshimeve teknike që i referohen por jo vetëm ndryshimit të të dhënave të krahasuara në mes të dhënave nga sistemet e operatorëve me të dhënat e gjurmëve të përgjimeve në pajisjet brenda njësisë ndërlidhëse dhe qendrave monitoruese, mos-përputhjes, mos respektimit të afateve kohore të urdhërit nga ana operatorëve të rrjetit dhe apo ofruesi i shërbimeve, Komisioneri do të njoftoj ARKEP me gjetjet e raportit nëse shkeljet e tilla involvojnë veprime të operatorëve të licencuar nga ana e ARKEP. Në rast të gjetjes së shkeljeve nga operatorët e telekomunikacionit, ARKEP i adreson shkeljet e tilla sipas këtij ligji dhe Ligjit për Komunikime Elektronike sa i përket fushës së saj të kompetencës.

7. Komisioneri ka qasje të plotë në institucionet e autorizuara për të zbatuar vendimet për përgjim të ligjshëm dhe në tërë aparaturat përcjellëse teknike që i shërbejnë një qëllimi të tillë.

8. Komisioneri e realizon qasjen nga paragrafi 6 i këtij neni në mjediset e AKI-së në konsultim dhe pas autorizimit prej Inspektorit të Përgjithshëm të AKI-së.

9. Komisioneri e realizon qasjen nga paragrafi 6 i këtij neni në mjediset e Policisë së Kosovës në konsultim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.

10. Komisioneri duhet të bashkëpunoj ngushtë me Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë.

11. Komisioneri nuk mund të ketë qasje në përmbajtjen e materialeve të përgjuara.

12. Konkluzionet e Komisionerit nuk ndikojnë në procedurën e ankesës individuale pranë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP).

Neni 35

Mbështetja teknike për Komisionerin

Këshilli Gjyqësor i Kosovës përmes akteve brendshme do të rregulloj angazhimin e zyrtarëve, mbështetjen teknike dhe procedurat e tjera të nevojshme për realizimin e mandatit të Komisionerit më së largu tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KREU VI DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 36 Dispozitat Kalimtare

1. Kryeprokurori i Shtetit brenda një periudhe 6 (gjashtë) mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji, funksionalizon njësinë ndërlidhëse dhe procedurat e infrastrukturës transitorë dhe burimet njerëzore.
2. Gjatë kësaj periudhe transitorë, Kryeprokurori i Shtetit asistohet nga Policia e Kosovës dhe Operatorët e Rrjetit për të funksionalizuar njësinë ndërlidhëse dhe procedurat rrjedhëse si në kuptimin teknik ashtu edhe në kuptimin e resurseve humane. Një asistencë e tillë duhet mbështetur financiarisht edhe nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.
3. Të dhënat lidhur me thirrjet e trafikut, që janë mbledhur dhe janë ruajtur në përputhje me ligjin, sipas urdhrat gjyqësor, nga një operator rrjeti ose ofrues i shërbimeve, duhet të vazhdojnë të ruhen nga operatorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimeve për një periudhë nëntë (9) mujore pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
4. Operatorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimeve duhet t'i vejnë në dispozicion të dhënat e mbledhura dhe të ruajtura sipas paragrafit 3 të këtij neni për një periudhë prej nëntë (9) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij.

Neni 37

Dispozitat e këtij Ligji do të mbizotërojnë në rast të konfliktit me dispozitat e Ligjit për Komunikime Elektronike.

Neni 38 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr.05/L-30
28 maj 2015**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kadri VESELI